



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:218807

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05813192

2023:221483

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL, me gjyqtaren e vetme gjykuese Hakile Ilazi dhe me zyrtarin ligjor Ymri Ibrahim, në çështjen penale kundër të pandehurit S.L., për shkak të veprave penale mbajtja në pronësi , kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr.1078/23 të datës 18.10.2023, në praninë e prokurorit të shtetit Mimoza Syla Hyseni dhe të pandehurit S.L. me mbrojtësin e caktuar sipas detyrës zyrtare av.Arbnor Hasani, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik më dt. 13.05.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 12.06.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I Akuzuari: S.L., i lindur me ... në fshatin K. Komuna Ferizaj, me vendbanim në Z., nga i ati L..., dhe e ëma S.. e gjinisë B..., i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, babai i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion kopshtar-bujk, shqiptarë, shtetase i Republikës së Kosovës me numër personal 1...

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I

Se nga data e papërcaktuar e deri me datë 31 Korrik 2023, rreth orës 23:00, saktësisht në fshatin ..., Komuna Ferizaj, mban në posedim të paautorizuar armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armë, ashtu që natën kritike i gjendet dhe i sekuestrohet arma - revole e llojit Ekol Special e kal.9 mm, me numër serik EU-19....., një fishke si dhe një karikatorë, këto i ka poseduar pa leje të organit kompetent dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armë,

- **me të cilën ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së,**

II

Me datë 31 Korrik 2023, rreth orës 23:00, në fshatin ..., Komuna Ferizaj, saktësisht në oborrin e tij në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët ka përdor armën-revolen e llojit E..e kal.9 mm, me numër serik EU-....., ashtu që gjatë një ahengu familjarë, ka gjuajtur në ajër (hapësirë),

- **me të cilën ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së,**

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 53, 69, 70, 366 dhe 367 të KPRK-së si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurin e,

G J Y K O N

Në dispozitivin e pare

Me dënim me gjobë prej 800€ (tetë gjind euro), i cili dënim do të ekzekutohet në dy këste për 6 ditë pagesën pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në dispozitivin e dyte

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës kohore prej dy (2) viti pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

Nëse i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin me gjobë konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që njëzet (20) euro gjobë të pa paguara do të jenë ekuivalente me një (1) ditë burgim.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së ,konfiskohet në mënyre të përhershme arma e tipit Ekol S.. e kal.9mm, me numër serik EU..., si dhe një fishek dhe një karikatorë, e përdorur për kryerjen e veprave penale, si në dispozitivat e këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, si dhe për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II nr.1078/23 të datës 18.10.2023 e ka ngarkuar të pandehurin S.L., për shkak të veprave penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 13.05.2024 në të cilin shqyrtim ishin të pranishëm prokurori i shtetit Mimoza Sylja Hyseni, i pandehuri S.L. me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare av. Arbnor Hasani.

Pasi që gjykata e ka udhëzuar të pandehurin në kuptim të nenit 241 par.1 të KPPK-se dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, në pajtim me nenin 241 par.3 të KPPK-së shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, duke vepruar sipas nenit 241 par. 4 të KPPK-së i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I pandehuri S.L. lidhur me të drejtën për tu deklaruar lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale që e ngarkon aktakuza, se pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare dhe se është i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimit të fajësisë, është penduar thellë , kërkon falje publike, është hera e parë që ka kryer vepër penale, shton se arma kishte qenë me gaz dhe e kishte përdorur për shkak të një ahengu familjar, premtos se më nuk do të përsëris vepra të tilla penale si dhe e ka lutur gjykatën që të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe t'i shqiptojë një dënim më të butë.

Prokurori i shtetit Mimoza Sylja Hyseni lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pasi që ky pranimi i fajësisë është bërë konform nenit 242 të KPRK-së, pranimi i fajësisë është në mënyrë vullnetare, i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe ky pranim i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza andaj i ka propozuar gjykatës që ta marrë parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri. I ka propozuar gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se ky pranimi i fajësisë është bërë konform nenit 242 të KPRK-së ,pranimi i fajësisë ishte bërë në mënyrë vullnetare , i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë pas konsultimeve të mjaftueshme me të si mbrojtës, dhe se ky pranim i fajësisë është i mbështetur në çështjet që përmban aktakuza , i kishte propozuar gjykatës që të merrte parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri . I kishte propozuar gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar dhe faktin se i akuzuari kishte rënë për herë të parë ndesh me ligjin , andaj në bazë të këtyre rrethanat të shqiptoj një dënim sa më të butë në të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit. Kishte propozuar një dënim me kusht ose gjobë në minimumin e paraparë me ligj.

Meqë i pandehuri e ka pranuar fajësinë, gjyqtarja e vetme gjykuese ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 242 par.2 të KPPK-së, i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet

e prezantuar nga prokurori i shtetit, dhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: Deklarata e të pandehurit S.L. , vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve dt.01.08.2023, fotografit si dhe shkresat e tjera që gjenden në lëndë.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtarja e vetme gjyquese konform nenit 242 par.6 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të figurës së veprave penale Mbajtja në pronësi , kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe vepra penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të përshkruar në datën, vendin, kohën dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se në shqyrtimin fillestar i pandehuri e ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, është mbajtës i familjes, konkretisht baba i katër fëmijëve, ndërsa në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe me rastin e vlerësimi të rrethanave rënduese gjykata mori parasysh peshën e veprës penale për të cilën është akuzuar.

Andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitivat të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Vendimi mbi konfiskimin e armës, një fishekut dhe një karikatorit është marr në kuptim të dispozitës së nenit 366 par.3 dhe 367 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 paragrafi 1 lidhur me nenin 449 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
2023:221483, me dt.12.06.2023

Zyrtari Ligjor

Ymri Ibrahim

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Hakile Ilazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Ferizaj.